

Shkollat Publike Agawam



1305 Springfield Street Suite 1
Feeding Hills, MA 01030-2198

SHEILA M. HOFFMAN, M. ED.
Asistente e Shefit për Programin Mësimor,
Udhëzimin dhe Kuadrin
(413) 821-0568

STEVEN P. LEMANSKI, M. ED.
Shef i Drejtorisë Arsimore
(413) 821-0548
Faks (413) 789-1835
www.agawamed.org

ROBERT CLICKSTEIN, M.B.A.
Administrator i Biznesit Shkollor
(413) 821-0550

Janar 2020

Të dashur prindër dhe kujdestarë:

Dëshiroj të përfitoj nga rasti për t'ju treguar për një trajnim të freskët në të cilin personeli ynë mori pjesë më 4 dhjetor 2019. Në atë datë, u bë një *Praktikë e Ribashkimit*, gjatë së cilës prindërit, që u portretizuan nga mësues, u kërkohet që të merrnin studentët e tyre në një largim zyrtar, të kontrolluar për daljen nga shkolla. Ribashkimi mund të jetë i domosdoshëm për një sërë arsyesh, si p.sh. ikja e dritave, moti, rreziku toksik, ose në rast se ndodh ndonjë krizë në shkollë. Të paturit e protokollit të ribashkimit për largimin nga shkolla e bën këtë proces më të parashikueshëm dhe me më pak kaos për të gjithë. Meqënëse ribashkimi nuk është një ngjarje e zakonshme e përfundimit të ditës së shkollës, studentët mund të drejtohen në një vendndodhje të ndryshme nga shkolla që ndjekin ata zakonisht.

Sipas këshillimit dhe drejtimit të Fondacionit "*Ju dua shumë miq*", personeli ynë ka kryer një trajnim fillestar se si të ribashkojë fëmijët me prindërit dhe kujdestarët e tyre. Dokumenti i bashkëngjitur përmban informacion jetik për kujdesdhënësit që do të ndihmojnë në një përpjekje të koordinuar për të ribashkuar studentët me prindërit/kujdestarët e tyre. Drejtorët e ndërtesës do t'ju tregojnë informacion rreth shkollave specifike në të ardhmen.

Lutemi tregoni vëmendje të madhe sidomos tek fushat e mëposhtme në dokument:

- **Çfarë ndodh nëse prindi nuk mund t'a marrë studentin e tij?** Nëse një prind/kujdestar nuk është në gjendje që ta marrë studentin e vet, personi i autorizuar duhet që të ketë një letër leje të nënshkruar nga prindi që studenti t'i lëshohet kujdestarisë së tyre.
- **Çfarë ndodh nëse nxënësi erdhi me makinën e vet në shkollë?**
- **Sillni dokument identifikimi për t'u kontrolluar**

Praktikat e Ribashkimit janë një shtresë më shumë e *Trajnimit ALICE*, në të cilin i gjithë personeli në distrikt ka marrë pjesë. Këto praktika do të vazhdojnë të kryhen me studentët dhe personelin gjatë gjithë vitit shkollor. Shkollat Publike Agawam do të vazhdojnë që të përmirësojnë procedurat e sigurisë në bashkëpunim me Departamentin e Policisë Agawam dhe ne e vlerësojmë bashkëpunimin e këtij departamenti, nën drejtimin e Shefit Eric Gillis, për të mbajtur studentët, personelin dhe shkollat tona të sigurt.

Sinqerisht,

Steven P. Lemanski Shefi i Drejtorisë
Arsimore

af

Bashkëngjitje

"Vini fëmijët të parët"



METODA™ STANDARDE E RIBASHKIMIT

RIBASHKIMI STUDENT/PRIND

Mund të ndodhin situata në shkollë që kërkojnë që prindërit t'i marrin studentët e tyre në një largim zyrtar, të kontrolluar për daljen nga shkolla. Ky proces quhet Ribashkim dhe mund të jetë i domosdoshëm për një sërë arsesh, si p.sh. ikja e dritave, moti, rreziku toksik, ose në rast se ndodh ndonjë krizë në shkollë. Metoda Standarde e Ribashkimit është një protokoll që e bën këtë proces më të parashikueshëm dhe me më pak kaos për të gjithë. Meqënëse ribashkimi nuk është një ngjarje e zakonshme e përfundimit të ditës së shkollës, studentët mund të drejtohen në një vendndodhje të ndryshme nga shkolla që ndjekin ata zakonisht. Nëse kjo vendndodhje është një shkollë tjetër, atëherë ata studentë gjithashtu mund t'i nënshtrohen një largimi të kontrolluar nga shkolla.

NJOFTIMI

Prindërit mund të njoftohen në disa mënyra. Shkolla ose distrikti mund të përdorin sistemin e tyre të lajmërimit me telefon ose mesazhe teksti. Në disa raste, studentëve mund t'u kërkohej që t'u dërgojnë mesazh me tekstin prindërve të tyre. Mesazhi me tekst i Ribashkimit mund të duket pak a shumë si ky: *"Shkolla është mbyllur, të lutem më merr në 3:35 tek hyrja kryesore. Sill Dokumentin e Identifikimit"*.

ÇFARË PRITET NGA PRINDI/KUJDESTARI

Nëse prindi ose kujdestari është njoftuar që do të jetë e nevojshme Ribashkimi, atëherë pritet që prindërit ose kujdestarët të dinë disa gjëra. Së pari, sillni dokumentin e identifikimit. Kjo do ta bëjë më të lehtë procesin e ribashkimit. Së dyti, kini durim. Ribashkimi është një proces që mbron edhe sigurinë e studentit, por edhe siguron një ndryshim të përgjegjshëm të kujdestarisë nga shkolla tek një prind apo kujdestar i njohur për marrjen e fëmijës.

ÇFARË NDODH NËSE PRINDI NUK MUND TA MARRË DOT STUDENTIN?

Nëse prindi nuk mund të shkojë tek vendi i ribashkimit menjëherë, studentët do t'u dorëzohen individëve që janë identifikuar qysh më parë si kontakt në rast urgjence për studentin. Ose, shkolla do t'i mbajë studentët derisa prindërit të vijnë ta marrin studentin e tyre.

ÇFARË NDODH NËSE STUDENTI SHKOI NË SHKOLLË ME MAKINËN E TIJ?

Mund të ekzistojë rasti kur studentit nuk i lejohej që ta lëvizë makinën e tij nga parkingu. Në këtë rast, prindit i kërkohej që të vinë ta marrin studentin. Në disa rrethana, studentët e shkollës së mesme mund të lirohen me fjalën e tyre.



INFORMACION RIBASHKIMI (LUTEMI SHKRUANI QARTË)

Mbajeni dokumentin e Identifikimit gati për t'ja treguar personelit shkollor të distriktit

Emri i studentit: _____

Klasa e studentit: _____ Nr. i celularit të studentit: _____

Emri i personit që merr studentin: _____

Nënshkrimi: _____

Nr. i telefonit i personit që merr studentin: _____

Marrëdhënia me studentin që merret: _____

A përputhet fotoja me personin që merr studentin? Po ose Jo

Plotësimi nga prindi:

Printo emrin e studentit përsëri: _____

Klasa e studentit: _____

Ditëlindja e studentit: _____

School Personnel complete upon release of student
Date: _____ Initials _____ Other _____

SI FUNKSIONON

Për sa i përket studentëve, shkolla kërkon që studentët të mbajnë rregull dhe qetësi gjatë pritjes. Studentëve mund t'u kërkohej që t'u dërgojnë mesazh me tekstin prindërve ose kujdestarëve të tyre. Gjithashtu, studentëve u kërkohej që të mos dërgojnë mesazhe të tjera në zonën brenda ose jashtë ribashkimit. Mbajtja e përdorimit të rrjetit celular në minimum mund të jetë e rëndësishme gjatë ribashkimit.

KARTAT E RIBASHKIMIT

Për prindërit, ka disa hapa. Nëse prindi po nget makinën në shkollë, ne këshillojmë që ata të marrin parasysh trafikun e rënduar dhe automjetet e urgjencës. Prindërit duhet të parkojnë aty ku lejohej dhe jo ta braktisin makinën e tyre. Prindërve u kërkohej që të shkojnë tek zona e Ribashkimit për t'u regjistruar dhe të krijojnë radhën në bazë të shkronjës së parë të mbiemrit të studentit. Kur të jenë në radhë, prindërve u kërkohej që të plotësojnë kartën e ribashkimit. Kjo kartë ka dy pjesë dhe do të ndahet gjatë procesit. Një pjesë e informacionit përsëritet në pjesën e sipërme dhe të poshtme të kartës. Prindërve u kërkohej që t'i plotësojnë të gjitha pjesët e kartës. Nëse keni për t'u ribashkuar me disa studentë, atëherë duhet të plotësoni nga një kartë për çdo student.

SILLNI DOKUMENTIN E IDENTIFIKIMIT PËR T'U REGJISTRUAR

Gjatë regjistrimit, do të konfirmohen identiteti dhe të drejtat e kujdestarisë. Karta ndahet dhe pjesa e poshtme i jepet përsëri prindërit.

Nga zona e 'Regjistrimit', prindërit drejtohen te zona e 'Ribashkimit'. Aty, dikush do t'ju marrë pjesën e poshtme të kartës dhe do të shkojë tek Zona e Grumbullimit të Studentëve për të marrë studentin ose studentët.

Prindërit duhet ta kenë parasysh që në disa raste, ata mund të ftohen brenda në ndërtesë për informacion të mëtejshëm..

INTERVISTA DHE KËSHILLIME

Në disa raste, prindërve mund t'u thuhet që po kryhet një hetim nga forcat e zbatimit të ligjit, dhe që mund të jetë e domosdoshme intervistimi. Në raste tepër ekstreme, prindërve mund t'u kërkohej informacione urgjence ose mjekësore.

